



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

Nr. 5313 Prot.

Tiranë, më 30.08, 2022

### POLITIKA KUNDËR RYSHFETIT

Në përputhje me misionin dhe strategjinë e saj, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) angazhohet në kryerjen e veprimtarisë së saj në mënyrë etike dhe të ndershme, duke vepruar me profesionalizëm, drejtësi dhe integritet. Për të përforcuar këtë angazhim, AKSHI implementoi Sistemin e Menaxhimit Kundër Ryshfetit sipas standardit ISO37001:2016, duke zbatuar në mënyrë të vazhdueshëm politikën, procedurat dhe praktikën që sigurojnë parandalimin e ryshfetit.

Me përkufizim, ryshfeti është ofrimi, premtimi, dhënia, pranimi ose kërkimi i një avantazhi të padrejtë të çdo lloji vlere, financiar ose jofinanciar, i drejtpërdrejtë ose jo, pavarësisht vendndodhjes, në kundërshtim me ligjet në fuqi, si një nxitje ose shpërblim për një person që vepron ose nuk vepron në përputhje me kryerjen e detyrave të tij.

Praktika të tilla jo vetëm që janë të ndaluara nga Kodi i Sjelljes dhe Etikës i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, por edhe nga lista e ligjeve si më poshtë vijon:

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Ligj Nr. 7895, datë 27.1.1995;  
Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, Ligj Nr. 7961 datë 12.07.1995;  
Ligji Nr. 9131, datë 8.9.2003 "Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike";  
Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"

Në përputhje me ligjet si dhe procedurat dhe politikën e brendshme, në këtë politikë shprehim angazhimin për të ndjekur me përpikmëri kërkesat e sistemit të menaxhimit kundër ryshfetit të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, duke respektuar në mënyrë të vazhdueshme të gjitha ligjet kundër ryshfetit dhe korrupsionit, në të gjitha fushat e veprimtarisë tonë. Gjithashtu, shprehim angazhimin për përmirësimin e vazhdueshëm të këtij sistemit dhe praktikave tona.

Pasojat e mosrespektimit të kësaj politike, procedurave të brendshme dhe legjislacionit në fuqi, mund të rezultojë në procedime disiplinore apo edhe penale drejt personave të përfshirë por dhe dëmtim serioz të reputacionit tonë në publik.

Kjo politikë kundër ryshfetit zbatohet për të gjithë punonjësit (qoftë të përkohshëm, me afat të caktuar ose të përhershëm), konsulentët, kontraktorët, individët në trajnim, vullnetarët, praktikantët, sponsorët ose çdo person tjetër që ka marrëdhënie me AKSHI-n, përfshirë palët e treta.

Të gjithë punonjësit dhe të gjithë personat nën kontrollin tonë janë njëloj përgjegjës për parandalimin, zbulimin dhe raportimin e ryshfetit dhe formave të tjera të korrupsionit. Atyre u kërkohet të shmangin çdo aktivitet që mund të çojë ose të nënkuptojë një shkelje të kësaj politike kundër ryshfetit.

Nëse ka një arsye për të besuar ose dyshuar se një rast ryshfeti ose korrupsioni ka ndodhur ose do të ndodhë në të ardhmen, ky shqetësim duhet të ngrihet në mirëbesim, mbi bazën e një besimi të arsyeshëm, në konfidencë, pa frikë nga ndëshkimi dhe në përputhje me:

- 1) Kodin Penal i Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 7895, datë 27.1.1995;
- 2) Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995;
- 3) Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë Ligji Nr.44/2015;
- 4) Ligjin Nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”;
- 5) Ligjin Nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtimin e funksioneve publike”;
- 6) Ligjin Nr. 60/2016, “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”;
- 7) Kodi i Sjelljes dhe Etikës, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;
- 8) Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 816, datë 16.11.2016 "Për Strukturën, Kriteret e Përzgjedhjes dhe Marrëdhëniet e Punës së Punonjësve të Njësisë Përgjegjëse në Autoritetet Publike, në zbatim të Ligjit Nr. 60/2016, “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve””;
- 9) Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.874, datë 29.09.2021 “Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”;
- 10) Procedura Antikorrupsion në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Nr. 575 Prot., datë 08.04.2015;
- 11) Rregullore e Brendshme mbi detyrat dhe funksionimin e AKSHI-t, Nr. 1900 Prot., datë 16.04.2020;
- 12) Rregullore “Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit”, Urdhër datë 16.10.2017;
- 13) Rregullore për Hetimin Administrativ të Kërkesës së Sinjalizimit për Mbrojtjen nga Hakmarrja në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit;
- 14) Rregullore për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, datë 12.12.2019;

Për të siguruar implementimin e duhur dhe përmirësimin e vazhdueshëm, AKSHI krijoi një grup pune të pajtueshmërisë kundër ryshfetit, me përgjegjësinë dhe autoritetin për të funksionimin e Sistemit të Menaxhimit Kundër Ryshfetit, konkretisht:

- duke ofruar këshilla dhe udhëzime për personelin mbi Sistemin e Menaxhimit Kundër Ryshfetit dhe çështjet në lidhje me ryshfetin;
- duke siguruar që Sistemi i Menaxhimit Kundër Ryshfetit të jetë në përputhje me kërkesat e ISO 37001:2016;
- duke raportuar mbi performancën e Sistemit të Menaxhimit Kundër Ryshfetit tek drejtuesi i institucioni dhe struktura të tjera të pajtueshmërisë, sipas rastit.

Përcaktimi i objektivave të sistemit të menaxhimit kundër ryshfetit është pjesë e procesit të zakonshëm të planifikimit operacional të AKSHI-t. Objektivat rishikohen të paktën një herë në vit, si pjesë e rishikimit nga grupi i punës.

AKSHI do të zhvillojë trajnime për këtë politikë si pjesë e procesit të integritetit të punonjësve të rinj. Punonjësit do të marrin gjithashtu trajnime të vazhdueshme dhe relevante se si t'i përmbahen kësaj politike dhe sistemit të menaxhimit kundër ryshfetit.

Kjo politikë dhe një qasje zero-tolerancë ndaj ryshfetit do t'u komunikohet qartë të gjithë punonjësve të AKSHI-t, furnitorëve, kontraktorëve, partnerëve dhe çdo pale të tretë në fillim të marrëdhënieve kontraktuale si dhe në vazhdimësi, sipas rastit.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**Mirlinda KARÇANAJ**

